



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:080156
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639991

KPPP.nr.2008/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Nëntë Vëllezërit” Sh.p.k me NUI 810454215 me seli në rrugën “ Josip Rela” nr. 18 Hyrja 1, nr. 4 Prishtinë, kundër debitorit “Sa-Sallahu” Sh.p.k me NUI 811233668, me adresë në fshatin Biçec, nuga “Baki Dullovi” nr. 158 Komuna Kaçanik, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1035/21 të datës 05.01.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Sa-Sallahu” Sh.p.k i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1035/21 të datës 05.01.2022,, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.1035/21 të datës 05.01.2022,, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Nëntë Vëllezërit” Sh.p.k, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.1035/21 të datës 05.01.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës numër 66-210-003-20 e datës 30.09.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur shumë prej 11,151.50 €, me kamatë ligjore prej 8%, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, ndër të tjerash ka theksuar se në këtë procedurë përmbartimore nuk është paraqitur vlera reale e obligimeve por një vlerë paushallë, pasi që vlera nuk është në përputhje me kartelën blerjeve sipas fletëdërgesave, ku janë paraqitur mospërputhje me blerjet reale, dhe kjo vlerë është e pa pranueshme, në vazhdim ka theksuar e sipas fletë dërgesës 20606 e datës 08.09.2020 për material FR 250 kemi rritje të sasisë nga kreditori nga 15m³ në 16 m³ në kartelën e blerjeve, pas analizimit të diferencave është paraqitur vlerë jo reale në faturë, në funde ka deklaruar se nuk pajtohet me propozimin për përmbartim dhe as vlerën e përmbartimit dhe titullin përmbartimor.

Kreditore, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se pretendimet e debitorit janë vetëm për shtyrje dhe prolongim të pagesës së borxhit, më tej ka shtuar se pretendimi i debitorit se ka mos përputhshmëri në mes të çmimeve nga fletëdërgesa dhe fatura dhe se është rritur sasia e material nuk qëndron, çmimet dhe sasia janë të pa ndryshuara si në faturë ashtu edhe në fletë dërgesë qëndron çmimi dhe sasia e njëjtë, në fund i ka propozuar gjykatë që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Faturën me 66-210-003-20 e datës 30.09.2020, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet*

dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht fatura e lartcekura i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se faturat është dorëzuar në origjinal nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit, andaj vërtetohet se debitori e ka pranuar faturën dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar asnjëherë.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim sa i përket faktit se sipas fletë dërgesës 20606 e datës 08.09.2020 për material FR 250 kemi rritje të sasisë nga kreditori nga 15m³ në 16 m³ në kartelën e blerjeve, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera te debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përbarimore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se urdhri për përbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2008/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.